



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. <sup>157</sup> ..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21/ 11 / 2023

**VENDIM**

Nr. 41, datë 21/11/2023

**PËR**

**PLANET E GADISHMËRISË NË RASTET E EMERGJENCAVE CIVILE PËR DIGAT E MËDHA TË SHFRYTËZUARA NGA BASHKIA DEVOLL**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.11.2023 mori në shqyrtim Planet e Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile për digat e mëdha të Koshnica 1&2, Grace, Baban, Selca, Trestenik, Borsh -Poloske, Vidohove, Poloske dhe Verlen që shfrytëzohen nga Bashkia Devoll

Planet e Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile për 10 digat e mëdha të përgatitur nga specialistët e Bashkisë Devoll të dorëzuara pranë KKDM rezultojnë se janë përgatitur në përgjithësi në përputhje me kërkesat e KKDM për hartimin e këtyre planeve të dhëna në Vendimin e KKDM Nr. 5, datë 16.11.2020.

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) rekomandoi KKDM-së të miratojë Planet e Emergjencave Civile të paraqitura nga Bashkia Devoll. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Planet e Gadishmerisë për rastet e emergjencave civile të 9 digave të mëdha që shfrytëzohen dhe administrohen nga Bashkia Devoll sic janë: Koshnica 1, Grace, Baban, Selca, Trestenik, Borsh -Poloske, Vidohove, Poloske dhe Verlen
2. Ti kërkojë Bashkisë Devoll:
  - Përgatitjen e hartave të përmbytyjeve dhe percaktimin e zonave me rrisht të lartë në rastet e prurjeve maksimale të ujit me përsëritje një herë në 100 vjet, 1 herë në 1000 vjet dhe në rast të prishjes së mundshme të ndonjë prej këtyre digave
  - Përgatitjen e projekteve për Instalimin e Sistemeve të Alarmit në digat e mëdha që janë me rrisht të lartë për humbjen e jeteve të njerezve në zonat urbane poshtë tyre në rast të prurjeve të mëdha apo prishjes së mundshme të ndonjë dige.
  - Informacion në lidhje me gjëndjen aktuale të digës Koshnica 2 dhe rezervuarit të krijuar prej tij e cila është jashtë funksionit. Në këtë informacion duhet të përfshihet edhe gjëndja e mbushjes së rezervuarit me sedimente si dhe fakti nëse ky rezervuar mund të kryejë funksionin për ujitje të tokave poshtë tij

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjisllacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**